



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500303/4

Tiranë ___/___/2015

Lënda: Rekomandohet " Marrja e masave me qëllim zbatimin korrekt të dispozitave procedurale për "Arrestin në flagrancë" ndaj autorëve të dyshuar për kryerjen veprës penale "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike" si, dhe sjelljen etike e profesionale të punonjësve të Policisë së Shtetit".

Drejtuar : Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr.1
Z. Artion DUKA

Për dijeni: Drejtorit të Policisë të Qarkut
Z.Ardian ÇIPA

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi L. A., banues në Rrugën "Shefqet Ndroqi" nr.185 Tiranë, i cili ka ngritur pretendimin se nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr.1, është "Arrestuar në flagrancë" në mënyrë të padrejtë, si person i dyshuar për vjedhje të energjisë elektrike, dhe se sjellja e punonjësve të policisë të cilët e kanë shoqëruar nuk ka qënë korrekte.

Qytetari L. A., prej vitit 2008, ka lidhur me degën e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike CEZ, zona CC1, kontratën për pajisje me energji elektrike me nr.M/552318, duke kryer deri në muajin Shkurt 2015, likuidimin e të gjitha pagesave të faturave të energjisë elektrike që janë vendosur afrofe, ku pagesa e fundit e datës 23 Shkurt 2015, i përket muajit Janar 2015.

Rrethanat e ngjarjes

Në ditën e ngjarjes datë 19.02.2015, rreth orës 13.00 në banesën e tij kanë shkuar një grup kontrolli i OSHEE-së të cilët pa marrë parasysh dokumentet e paraqitura nga bashkëshortja e tij, kanë bërë prerje të energjisë elektrike.

Pasi është informuar për veprimin e kryer nga punonjësit e OSHEE-së, në këtë ditë rreth orës 14.30 qytetari L. A., ka shkuar për t'u ankuar pranë drejtorisë së OSHEE, ku specialistët e asaj zyre pasi kanë verifikuar kontratën në sistem, konstatuan se klienti kishte kryer të gjitha pagesat prej vitit 2007, dhe për rrjedhojë nuk ishte debitor. Ata gjithashtu e kanë sqaruar se do të urdhëronin punonjësit e tyre, për të rilidhur energjinë elektrike në banesë, veprim i cili u relaizua në orën 16.30 të po asaj dite.

Në banesë qytetari L. A., është kthyer në orën 19.30 të datës 19.02.2015, pasi duke qënë aktivist i Shoqërisë Civile dhe drejtues i Shoqatës "MedAlb Institut", ishte angazhuar në misionin humanitar për mbështetjen e ndihmave të komunitet rom dhe atij egjyptian, në zonat e përmytura të Beratit dhe Novoselës.

Ndërsa ai ishte duke ngrënë darkë me bashkëshorten dhe tre fëmijët e tij të mitur, në banesë ka ardhur një grup punonjësish të OSHEE-së, të cilët i thanë se kishte bërë rilidhje të paligjshme të energjisë elektrike, por pas verifikimit u konfirmua se nuk kishte asnjë ndërhyrje në rrjetin e energjisë elektrike. Në këto rrethana qytetari L. A., ju ka thënë të largoheshin nga banesa, por punonjësit e OSHEE-së menjëherë kanë njoftuar Policinë.

Punonjësve të policisë të Komisarariatit nr.1 R. D., dhe A. K., qytetari L. A., ju ka paraqitur dokumentet duke sqaruar se kishte bërë pagesat dhe se energjinë elektrike e kishin rilidhur vetë punonjësit e OSHEE, por ata pa marrë parasysh sqarimet e tij e kanë shoqëruar në gjëndjen që ishte me rrobat e shtëpisë duke i thënë se do të bënin verifikim e do ta kthenin përsëri në banesë.

Në Komisariatin e Policisë shtetasi L. A., është marrë në pyetje nga oficeri i Policisë Gjyqësore z. I. B., të cilin e ka sqaruar se nuk kishte kryer asnjë veprim të kundërligjshëm, duke i vënë në dispozicion dhe dokumentet përkatëse. Në pozitën e personit nën hetim ai i ka kërkuar oficerit të Policisë Gjyqësore provat që dispononte për akuzën në ngarkim të tij dhe ballafaqimin me punonjësit e OSHEE-së, por kërkesa e tij nuk është marrë në konsideratë. Në orën 24.00, Policia Gjyqësore ka përpiluar vendimin e "Arrestit në flagrancë" të shtetasit L. A.

Konstatime dhe sugjerime

Duke paraqitur ankesën në Institucionin e Avokatit të Popullit, qytetari L. A., ka ngritur me shqetësim sjelljen jo korrekte dhe profesionale të punonjësve të policisë të Komisarariatit nr.1 Tiranë.

Kështu, qysh në momentin kur në banesë kanë shkuar punonjësit e policisë, ata e kanë marrë me nxitim shtetasin L. A., të veshur me rrobat e shtëpisë dhe shapka, duke krijuar një situatë paniku tek bashkëshortja dhe fëmijët e mitur. Pasi është shoqëruar në Komisariatin e Policisë, ai është mbajtur në mjediset e brëndshme në kushte ankthi e presioni deri në orën 0.5.00 të datës 20 Shkurt, ku edhe i janë vendosur prangat. Më pas i arrestuari është vendosur në një dhomë sigurie me kushte që lenë për të dëshiruar, me një hapësirë të pamjaftueshme, pa shtretër dhe mbulesa, ku ndodheshin dhe disa persona të tjerë, rrethana të cilat e kanë detyruar të refuzoja ushqimin deri në momentin e lirim të datë 22.02.2015, ora 15.30, pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për caktimin e masës së sigurimit "Detyrim për Paraqitje në Policinë Gjyqësore.

Shprehim mendimin se Policia Gjyqësore në marrjen e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike”, duhet të mbajë në konsideratë kushtet dhe kriteret e caktimit të saj, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht nenet 228, 229 dhe 230 të tij.

Për rastin e aplikimit të “Arrestit në flagrancë” të qytetarit L. A., nuk ekziston asnjë prej kriterëve të parashikuara në nenin 228/3 të Kodit të Procedurës Penale, siç janë mospasja e asnjë shkakut të rëndësishëm për vënien në rrezik për marrjen ose vërtetësinë e provës, dhe pa asnjë rrezik për largimin e personit të dyshuar.

Vepra penale për të cilën dyshohet qytetari L. A., nuk paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe po kështu vetë i dyshuari, i cili paraqitet me personalitet të mirë.

Vendosja e masës së sigurimit personal “Arrest në flagrancë” duhet të jetë një rast përjashtimor dhe si masë e fundit, e cila duhet të aplikohet në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit, të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikon vepra penale, si dhe kur masat e tjera nuk janë të përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj.

Standarti kryesor për privimin e lirisë së personit nëpërmjet arrestimit është arsyeshmëria, e parë kjo në kontekst me rrethanat konkrete dhe arsyet e veçanta të faktit i cili duhet të derivojë në sjellje apo marrjen e vendimeve në favor të subjekteve më të dobëta.

Asnjë përpjekje nga ana e Policisë për t'i bërë të qartë personit të shoqëruar të drejtat që ai gëzon, pasi ky është dhe momenti i përballjes me Policinë e Shtetit. Këto të drejtat, qytetarit L. A., i janë bërë prezent vetëm në momentin e marrjes në pyetje nga oficeri i Policisë Gjyqësore.

Veç sa sipër do të sugjerohet manifestimin e një sjellje etike policore dhe respektimin e standarteve profesionale, pasi vetëm në këtë mënyrë dhënia e shërbimeve të policisë me komunitetin është e cilësisë më të lartë. Kjo për faktin se dhe në nenet 2 dhe 85 të ligjit nr.9749 datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.108/2014, të cilat bëjnë fjalë për misionin dhe parimet e veprimtarisë së Policisë së Shtetit, ruajtja e rendit dhe sigurisë publike nëpërmjet zbatimit të ligjit duhet të realizohen në respekt të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Policia Gjyqësore duhet të njohë dhe respektojë të drejtën që ka personi i dyshuar për kryerjen e një veprë penale, çka konsiston në verifikimin e kërkesave apo pretendimeve të tij qysh në fazën e kryerjes së veprimeve të para hetimore procedurale. Kjo është një procedurë që duhet të udhëhiqet nga parimi i prezumimit të pafajësisë si dhe duhet të menaxhohet me profesionalizëm të lartë, korrektësi dhe paanësi. Konstatohet se nga Policia Gjyqësore nuk rezulton të jetë kryer një veprim i tillë, por është mjaftuar vetëm me administrimin e proces verbalit të konstatimit nga grupi i punonjësve të OSHEE-së, dhe mandej dërgimin e materialeve organit të Prokurorisë.

Sa sipër, do të sugjerohet analizën e rastit, jo vetëm për respektimin e dispozitave procedurale, por dhe në sjelljen korrekte të punonjësve të policisë duke filluar nga shoqërimi i personave, mbajtja e tyre në mjediset e krijuara për këtë qëllim. Po ashtu, dhomat e sigurisë duhet të jenë të pastra dhe me komoditetin e nevojshëm. Kushtet fizike të ambienteve të qëndrimit duhet të

plotësojnë disa parametra të caktuar fizikë dhe materialë, duke përfshirë hapësirën fizike të dhomave, shtrat për person, shtroje të pastra personale etj. Kjo është edhe një nga përgjegjësitë e personelit policor me qëllim integritetin fizik e psikologjik të personave të ndaluar/arrestuar, gjithmonë nën kujdesin e tyre. Duhet tregohet kujdes në diferencimin për vendosjen e personave në dhomat e sigurisë dhe jo siç është vepruar në rastin konkret, ku qytetari L. A., ka qënë në një dhomë, bashkë me persona tjerë me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Për të gjitha arsyet dhe shkaqet e përmendura më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOHET

“Marrja e masave me qëllim zbatimin e dispozitav e proceduriale për rastet e “Arrestit në flagrancë” ndaj autorvë të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja e energjisë elektrike, ose impulseve telefonike”, si dhe sjelljen etike e profesionale të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi , të vihemi në dijeni brënda afatit 30 ditor , sipas nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* , me ndryshimet përkatëse.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

Konc.&.Dakt.P.A.
Tiranë më 13.04.2015

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI